



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARIANA DAKA
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 5,
RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI
PERDHE
TEL: 0692058147

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1913

Nr. koleksioni: 979

Tirane më 05/10/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2021053860112876224



A2021053860112876224

KONTRATË PËR SHITBLERJEN E KUOTËS

Sot, më datë 05 Tetor 2021, para meje Notere **MARIANA DAKA**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

Shoqëria GE-POR-TUR Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar më datë 01.04.1996 me Vendimin Nr. 14422 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën Porti i Jahteve, Orikum, Vlorë, me NUIS K06924212U, e përfaqësuar në këtë kontratë nga administratori i vetëm dhe përfaqësuesi ligjor, znj. Stella Giorgi, e datëlindjes 07.09.1977, lindur në Piombino (LI), Itali, shtetase italiane, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. AT7124286, lëshuar nga Bashkia e Piombino më datë 22.05.2014, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve datë 01.10.2021, këtu e më poshtë i quajtur “Shitësi”;

- **Shoqëria “Concord Investment” Shpk**, person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 14.06.2005, me Vendimin Nr. 33729, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën: rruga “Perlat Rexhepi” Nd.1. H 14, Ap 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, me NIPT K81602049K, e përfaqësuar në këtë kontratë nga administratorët e saj Z. Artan Dulaku, atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 30 Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Kompleksi i Vilave, Sauk, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 028592335 dhe numër personal G50530166T dhe z. Adrian Dulaku, atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 05.02.1960, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: bulevardi “Bajram Curri”, godina ETC, kati i 17-të, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035240347 dhe numër personal G00205223S, sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Concord Investment” Sh.p.k. datë 04.10.2021, këtu e më poshtë i quajtur “Blerësi”

Të dy bashkë të quajtur “Palët”

Palët kanë rënë dakort që të lidhin këtë Kontratë me kushtet e parashikuara si më poshtë vijon:

Duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake:

- 1) Shitësi është pronar i një kuote pjesëmarrjeje të barabartë me 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare “Giorgi Alfo” Sh.p.k., me seli në Vlorë në adresën Porti i Jahteve, Orikum, me kapital themeltar 100.000 (njëqindmijë) Lekë, regjistruar në Regjistrin Tregtar Tiranë me NUIS J66915255J, (në vijim, edhe “Shoqëria”);
- 2) Shitësi ka dakordësuar t’i shesë Blerësit dhe Blerësi ka dakordësuar të blejë nga Shitësi kuotën me vlerë nominale 100.000 Lekë (njëqindmijë) Lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të



A2021053860112876224

Shoqërisë (në vijim edhe “**Kuota**”), kundrejt çmimit dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë kontratë.

Sa më sipër, Palët bien dakord dhe vendosin për sa më poshtë:

1. KUSHTET PARAPRAKE

Kushtet paraprake të kësaj kontrate konsiderohen si pjesë përbërëse e saj (në vijim, “Kontrata”)

2. OBJEKTI I KONTRATËS

Shitësi i shet dhe transferon Blerësit, dhe Blerësi blen, sipas kushteve të parashikuara në këtë kontratë, kuotën e pjesëmarrjes së Shitësit në Shoqërinë Giorgi Alfo Sh.p.k., me vlerë nominale 100.000 (njëqindmijë) Lekë, të barabartë me 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

3. ÇMIMI

Çmimi total për shitjen e Kuotës është 400.210,59 Euro (katërqindmijë e dyqind e dhjetë, presje pesëdhjetë e nëntë) Euro, shumë që do të paguhet nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, me transfertë bankare në llogarinë e Shitësit GE-POR-TUR Sh.p.k.

4. DEKLARATAT DHE GARANCITË E SHITËSIT

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton se:

- A. Është pronar i ligjshmëm dhe i vetëm i Kuotës.
- B. Kuota është lirisht e disponueshme, nuk është vënë peng apo garanci si dhe nuk është subjekt kufizimesh, të drejtash apo pretendimesh të çfarëdo lloji nga palë të treta;
- C. Nuk ka palë të treta që gëzojnë të drejtën e parablerjes së Kuotës.

4.2. Në lidhje me Shoqërinë, Shitësi deklaron dhe garanton sa vijon:

- A. **Detyrimet.** Shoqëria nuk ka detyrime të tjera përveç atyre që rezultojnë nga nga Pasqyrat financiare të Shoqërisë, si dhe nga raporti i auditit të pasqyrave financiare deri më 30.09.2021, që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, dhe Shitësi nuk është në dijeni të ndonjë situatë ose rrethane që mund të bëjë të vlerësosh të mundur lindjen e ndonjë detyrimi në të ardhmen.
- B. **Detyrimet tatimore.** Shoqëria ka shënuar rregullisht në librat dhe regjistrat kontabël të gjitha transaksionet e biznesit, duke i raportuar ato për të gjitha qëllimet tatimore, si për tatimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, dhe për taksat dhe i ka dorëzuar zyrave kompetente të administratës publike të gjitha raportet dhe të dhënat e nevojshme, për qëllimet tatimore të kërkuara nga ligji, të hartuara në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, si dhe ka paguar të gjitha taksat dhe tatimet që ka patur detyrim. Shoqëria nuk është e përfshirë në akte a procedura gjyqësore në proces e sipër, lidhur me vlerësimin ose mbledhjen e taksave, interesav për vonesë pagesash, gjobave ose pagesave të pjesshme, si dhe akte apo procedura të tilla gjyqësore nuk rezultojnë të jënë njoftuar kundër saj nga autoritetet tatimore.
- C. **Kreditë.** Të gjitha kreditë e Shoqërisë dhe ato të maturuara deri në datën e kësaj Kontrate janë të vërteta dhe reale, ato rezultojnë nga kontrata dhe / ose fatura, por për to nuk garantohe mbledhja.



A2021053860112876224

D. **Regjistrimet kontabël:** Shoqëria ka mbajtur me kujdesin e duhur të gjithë librat dhe regjistrimet kontabël në lidhje me biznesin e saj, duke kryer menjëherë të gjitha regjistrimet e kërkuara nga ligji.

4.3. Shitësi merr përsipër të garantojë Blerësin për një periudhë 3-vjeçare lidhur me detyrime të mundshme të shoqërisë Giorgi Alfo Shpk që nuk rezultojnë të regjistruara në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate si dhe për detyrime që mund të rezultojnë nga kontrolle të mundshme të autoriteteve tatimore, të konfirmuara me vendim gjykate të formës së prerë, në lidhje me periudhën që i paraprin momentin të kalimit të kuotës.

5. DEKLARATAT DHE GARANCITË E BLERËSIT

5.1. Blerësi deklaron se është njohur me statutin, veprimtarinë e Shoqërisë, si dhe gjendjen pasurore të saj siç rezulton më datën e sotme dhe se ka kryer të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të Shoqërisë, duke përfshirë mbi sa vijon:

- a) Kontratat e lidhura nga Shoqëria Giorgi Alfo Sh.p.k. me Shtetin Shqiptar për zhvillimin e Portit Turistik të Orikutit;
- b) Lejet dhe autorizimet administrative të marra nga Shoqëria në lidhje me ndërtimin dhe zhvillimin e Portit Turistik të Orikutit si dhe dokumentacionin përkatës mbi pronën që rezultojnë nga kadastra;
- c) Kontratat e lidhura nga Shoqëria me klientët e saj për dhënien e apartamenteve dhe vendeve të barkave.
- d) Librat kontabël dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë deri më datën e sotme.

5.2. Blerësi deklaron dhe garanton se e blen Kuotën në gjendjen juridike dhe faktike në të cilën ndodhet dhe merr përsipër të paguajë njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate të gjitha detyrimet që Shoqëria ka ndaj të tretëve, sikurse pasqyruar në raportin e auditit të pasqyrave financiare të Giorgi Alfo Sh.p.k. deri më 30.09.2021, duke marrë kështu cilësinë e kreditorit (ortak) ndaj Shoqërisë lidhur këto detyrime.

6. EFEKTET E KALIMIT TË KUOTËS

Kalimi i titullit të pronësisë mbi Kuotën, në bazë të kësaj Kontrate, do të ketë efekt nga dita e pagesës së çmimit të plotë të shitjes në llogarinë e Shitësit.

7. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo Kontratë, përfshirë ato që mund të lidhen me vlefshmërinë, interpretimin dhe zbatimin e saj, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

9. SHPENZIMET E KONTRATËS

Shpenzimet që lidhen me hartimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate janë në ngarkim të Blerësit.

10. LIDHJET E KONTRATËS



A2021053860112876224

Bashkëlidhur kësaj Kontrate janë:

- (i) Ekstrakti i QKB i Shoqërisë “CONCORD INVESTMENT” Shpk ;
- (ii) Ekstrakti i QKB i Shoqërisë “GIORGI ALFO” Shpk;
- (iii) Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të GE-POR-TUR Sh.p.k, datë 01.10.2021;
- (iv) Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “CONCORD INVESTMENT” Shpk datë 04.10.2021;
- (v) Raporti i Auditit të pasqyrave financiare më 30.09.2021;
- (vi) Dokumentet identifikuese të nënshkruesve;
- (vii) Mandatpagesa bankare për likuidimin e çmimit.

Kjo Kontratë u hartua në katër kopje, nga të cilat dy kopje për palët e kësaj kontrate, një kopje mbetet në dokumentacionin e Shoqërisë “GIORGI ALFO” Shpk dhe një kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë.

Kjo Kontratë pasi u lexua në gjuhët shqip dhe italisht, në praninë e përkthyeses Annamaria Xhuli dhe u gjet në rregull, nënshkruhet pa vërejtje nga Palët sipas vullnetit të tyre të lirë e të plotë, konform ligjit.

SHITËSI

GE-POR-TUR Sh.p.k.

Perfaqesuar nga:

Stella Giorgi

Ge. Por. Tur. sh.p.k.
++39 0565 252040 MARINA ORIKUM
K08924212U ORIKUM (VLORE)

BLERËSI

CONCORD INVESTMENT Sh.p.k.

Perfaqesuar nga:

Adrian Dulaku

Artan Dulaku



NOTERE

MARIANA DAKA



V E N D I M

I ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË

SHOQËRISË “CONCORD INVESTMENT” SHPK

Sot, më datë 04 Tetor 2021, në selinë e Shoqërisë “Concord Investment” Shpk, të ndodhur në adresën: Rr. “Perlat Rexhepi”, Ndërtesa Nr.1, Hyrja 14, Ap.7, Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019, Tiranë, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të kësaj Shoqërie.

Shoqëria “Concord Investment” Shpk, e rregjistruar në QKB me NIPT K81602049K, gjatë veprimtarisë së saj drejtohet nga Administratorët z. Adrian Dulaku dhe z. Artan Dulaku.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Concord Investment” Shpk, e thirrur me kërkesën e Administratorëve z. Adrian Dulaku dhe z. Artan Dulaku.

Verifikohet pjesëmarrja e ortakëve dhe rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- Z. Adrian Dulaku, i cili përfaqëson 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë,
- Z. Artan Dulaku, i cili përfaqëson 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë
- Z. Genci Dulaku, i cili përfaqëson 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë

që do të thotë se janë të pranishëm 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë “Concord Investment” Shpk, të cilët janë dakord të shqyrtojnë këto probleme sipas,

Rendit të ditës:

1. Miratimin e blerjes së 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “GIORGI ALFO” Sh.p.k të zotëruara nga shitësi Shoqëria “GE-POR-TUR” Shpk, kundrejt vlerës 400.210,59 Euro (katërqindmijëedyqinddhjetë, presje pesëdhjetëenëntë) Euro.
2. Autorizimin e Administratorëve z. Adrian Dulaku dhe z. Artan Dulaku, të nënshkruajnë Kontratën e shitjes së 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “GIORGI ALFO” Sh.p.k të zotëruara nga shitësi Shoqëria “GE-POR-TUR” Shpk.

06/10/21-07:57:46

EMPOPrint-2050-000001 1

----- Instance Type and Transmission -----
Notification (Transmission) of Original sent to SWIFT (ACK)
Network Delivery Status : Network Ack
Priority/Delivery : Normal
Message Input Reference : 0757 211006EMPOALTRXXX8397224530

----- Message Header -----
Swift Input : FIN 103 Single Customer Credit Transfer

Sender : EMPOALTRXXX
AMERICAN BANK OF INVESTMENTS S.A.
TIRANA AL

Receiver : CDISALTRXXX
CREDINS BANK S.A.
TIRANA AL

MUR : 901MSOG21278001U
UETR : ac3680f4-dd8a-4560-ad3c-13eb769fc330

----- FIN User Header -----
{10B 901MSOG21278001U}
{121 ac3680f4-dd8a-4560-ad3c-13eb769fc330}

----- Message Text -----

20: Sender's Reference
001FT01212780010

23B: Bank Operation Code
CRED

32A: Val Dte/Curr/Interbnk Settlid Amt
Date : 08 October 2021
Currency : EUR (EURO)
Amount : #400.210,59#

33B: Currency/Instructed Amount
Currency : EUR (EURO)
Amount : #400.210,59#

50F: Ordering Customer - ID
/AL93210110290000000000085618
1/CONCORD INVESTMENT SHPK
2/PERLAT REXHEPI NDERTESA 1
2/HYRJA 14
3/ALTIRANA

53A: Sender's Correspondent - FI BIC
RZBAATWWXXX
RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL AG
VIENNA AT

59: Beneficiary Customer-Name & Addr
/AL34212110090000000001585110
GE-POR-TUR SHPK
PORTI I JAHEVE, ORIKUM,
VLORE, ALBANIA

70: Remittance Information
PAYMENT AS PER CONTRACT
NO1913 INDEX NR979 FILING
DT 05/10/2021

71A: Details of Charges
OUR

----- Message Trailer -----

{CHK:A647141010BF}
PKI Signature: MAC-Equivalent

----- Interventions -----

Category : Network Report
Creation Time : 06/10/21 07:56:58
Application : SWIFT Interface
Operator : SYSTEM

Text

{1:F21EMPOALTRXXX8397224530}{4:{177:2110060757}{451:0}{108:901MSOG21278001U}}



GE-POR-TUR SH.P.K.
PORTI I JAHTEVE, ORIKUM
VLORE

Nr./21 Prot.

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË GE-POR-TUR
SH.P.K.

DATË 1 TETOR 2021

Sot, më datë 01.10.2021, ora 10:00, u mbledh Asambleja e Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë GE-POR-TUR Sh.p.k., me seli në adresën Porti i Jahteve Orikum Vlorë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 01/01/2000, NUIS K06924212U, me kapital themeltar 200.000 Leke (në vijim, "**Shoqëria**"), e thirrur më datë 24.09.2021 nga përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë u zhvillua nëpërmjet lidhjes më videokonferencë në platformën ZOOM, për t'u dhënë mundësinë ortakëve që ndodhen jashtë Shqipërisë që të marrin pjesë në mbledhjen e thirrur.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve u mbledh për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me këtë këtë rend dite:

1. Miratimi i ndryshimeve të statutit të shoqërisë;
2. Emërimi i administratorit të shoqërisë;
3. Miratimi i shitjes së kuotës në shoqërinë Giorgi Alfo Sh.p.k.;
4. Të ndryshme.

Janë të pranishëm në mbledhje ortakët e GE-POR-TUR Sh.p.k. si vijon:

- Shoqëria GE.POR.TUR S.R.L., zotërues i një pjesëmarrjeje të barabartë me 91% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, e përfaqësuar nga z. Riccardo Caroti, sipas vendimit të asamblesë të kësaj shoqërie të datës 30.09.2021, i lidhur në videokonferencë nga Livorno, Itali;
- Z. Vasillaq KEDHI, zotërues i një pjesëmarrjeje të barabartë me 4,50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, i lidhur me videokonferencë;
- Znj. Keti KEDHI, zotëruese e një pjesëmarrjeje të barabartë me 0,50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, e lidhur me videokonferencë nga i njejti vend ku ndodhet ortaku z. Vasillaq Kedhi.



- Znj. Aida KEDHI, zotëruese e një kuote të barabartë me 0,50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, e lidhur me videokonferencë;
- Z. Josif KEDHI, zotërues i një pjesëmarrjeje të barabartë me 0,50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, i lidhur me videokonferencë nga i njëjti vend ku ndodhet ortakut znj. Aida Kedhi;

Është gjithashtu e pranishme edhe noterja, znj. Lorian Robo.

Mbledhja kryesohet nga z. Riccardo Caroti, përfaqësuesi i ortakut të shumicës, me sekretare znj. Tullia Giorgi, edhe ajo e pranishme dhe e lidhur në videokonferencë nga i njëjti vend ku ndodhet edhe Kryetari, në adresën Loc. Valnera nr. 26 – Riotorto (LI), Itali, sikurse edhe përfaqësuesja e Shoqërisë, znj. Giovanna Antonietta Sticca.

Kryetari i mbledhjes pasi konstatoi se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë 97% të kapitalit themeltar të Shoqësisë, në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë", i ndryshuar, deklaroi mbledhjen të hapur dhe fillon diskutimin e çështjeve në rend të ditës.

Pas diskutimeve, në lidhje me rendin e ditës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me votën e shumicës së ortakëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në statutin e shoqërisë GE-POR-TUR Sh.p.k., sikurse pasqyrohen në dokumentin që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij;
2. Të emërojë znj. Stella Giorgi, lindur në Piombino (LI), më datë 07/09/1977, si administrator të vetëm të Shoqërisë nga dita e sotme për të gjithë afatin e përcaktuar nga ligji;
3. Të miratojë shitjen e kuotës që shoqëria GE.POR.TUR Sh.p.k. zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë GIORGI ALFO SH.P.K. për një çmim jo më të ulët se 400.000,00 (katërqindmijë) Euro, përkundrejt detyrimit të blerësit të mundshëm të marrë përsipër edhe të gjitha detyrimet që ka shoqëria Giorgi Alfo Sh.p.k. ndaj të tretëve, sipas pasqyrave financiare të kësaj të fundit.

Në mbyllje të diskutimeve mbi të gjitha çështjet në rend të ditës, Kryetari deklaroi mbledhjen e asamblesë të mbyllur.

Kryetari

Riccardo Caroti

Sekretari

Tullia Giorgi

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për: Ortakët e shoqërisë "Giorgi Alfo" shpk

Marina Orikum, Vlorë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare "Giorgi Alfo" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 05.10.2021 deri në orën 10.00 AM, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë tregtare "Giorgi Alfo" shpk, me datën 05.10.2021 deri në orën 10.00 AM, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara që zbatohen në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe me Ligjin Nr.25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të

nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë për këtë qëllim, kur është rasti, informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë nisur duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Organet që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arsyeshme megjithatë është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomalise materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.



- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Auditues ligjor

Elza Balla



Tiranë, më 05.10.2021

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|--|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K81602049K |
| 2. Data e Regjistrimit | 02/04/2008 |
| 3. Emri i Subjektit | CONCORD INVESTMENT |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 16/05/2005 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 16/05/2005 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga Perlat Rexhepi, Ndertesa Nr.1, Hyrja 14, Ap.7, Njesia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019 |
| 8. Kapitali | 847.161.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 3,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Investimi, zbatimi, zhvillimi, menaxhimi i zonave civile, industriale, turistike, si edhe sherbimeve te tjera te primtarive tregtare te ngjashme ose te lidhura me to. Kryerja e veprimtarive tregtare ne fushen e ndertimit, per prodhim dhe shitblerje te materialeve te ndertimit. Kryerja e aktivitetit per investimin ne fushen e ndertimit, ne komplekse civile, turistike, industriale, sociale, komplekseve te tregtimit dhe te sherbimit bar-restorant-hoteleri etj. Pjesemarrje ne projekte ndertimore, si sipermarres, investitor, konsulent, si dhe marrjen persiper te menaxhimit te tyre, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, import eksport i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise si dhe te treteve, ku perfshihen inerte, gure, gure dekorative, gelqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rere dhe çdo material tjetër per ndertim. Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve per rikonstruksionin e ndermarrjeve industriale. Kontraktimi me persona fizike dhe juridike vendas ose te huaj per gjetjen e tregjeve te shitjes per prodhimet dhe pune te shoqerise. Blerje-Shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme (prona te ndryshme, si troje, toka bujqesore, apartamente banimi, ambjente sherbimi dhe tregtimi etj., pasuri keto ne pronesi te shoqerise ose ne pronesi te shoqerive te tjera, personave fizike apo juridike, te cilet e |

| | | |
|--|---|--------------------------|
| | autorizojne per perfaqesim shoqerine, per blerje-shitje. | |
| 10. Administratori/ët | Adrian Dulaku | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 24/05/2019 | Deri: 25/05/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | Administratoret e Shoqerine mund te autorizojne njeri tjetrin per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimeshZ. Adrian Dulaku dhe Z. Artan Dulaku, te cilet mund te kryejne detyrat e administrimit te Shoqerise se bashku, apo vec e vec. | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Administratori/ët | Artan Dulaku | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 24/05/2019 | Deri: 25/05/2026 |
| 13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | Administratoret e Shoqerine mund te autorizojne njeri tjetrin per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimeshZ. Adrian Dulaku dhe Z. Artan Dulaku, te cilet mund te kryejne detyrat e administrimit te Shoqerise se bashku, apo vec e vec | |
| 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 14. Ortakët | AdrianDulaku | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 214.185.180,00 | Natyre: 65.377.950,00 |
| 14.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 33,00 | |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | | |
| 15. Ortakët | ArtanDulaku | |
| 15.1 Vlera e kapitalit | Para: 220.675.640,00 | Natyre: 67.359.100,00 |
| 15.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 34,00 | |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | | |
| 16. Ortakët | GenciDulaku | |
| 16.1 Vlera e kapitalit | Para: 214.185.180,00 | Natyre: 65.377.950,00 |
| 16.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 16.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 33,00 | |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse</i> | | |

| | |
|--|---|
| <i>zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | |
| 17. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Kashar KASHAR Objekti Mall of Tirana, per objektin e ndertimit te miratuar per tu ndertuar sipas vendimit nr 7, dt 22.02.2017, nga KKT, te objektit Struktura Sherbimi me Funkcion Magazinimi dhe Tregtimi 1-2 kate Vlore Sarande SARANDE Porti i Limjonit Sarande, me numer pasurie 5/232, Zona Kadastrale 8641, me sip. 5370 m2 Durres Ishem ISHEM Kompleksi Turistik San Pietro |
| 18. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: CONCORD INVESTMENT E-Mail: flora.ceko@edilal.com Telefon: 042271884 Të Tjera: Depozitim i vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve date 10.11.2009 per caktimin e ekspertes kontabel te autorizuar Znj.Tatiana Filto (Kotepano) me liçence nr.67 per rritje kapitali.Depozitim i Vendimit dt 29-06-2010 per caktimin e Ekspertit Kontabel,Zj.Tatiana Filto (Kotepano),per zmadhimin e kapitalit te shoqerise. |
| 19. Statusi: | Aktiv |

Datë: 03/09/2021

 Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
 (i nëpunësit të sportelit)

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|--|------------------|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K06924212U | |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/01/2000 | |
| 3. Emri i Subjektit | GE-POR-TUR | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 27/01/1996 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 27/01/1996 31/12/2091 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Vlore Orikum ORIKUM Porti i jahteve | |
| 8. Kapitali | 200.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 200,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ndërtim, administrim, shitblerje dhe dhenie me qera e ndertesave te cfaredolloji per perdorim tregetar, industrial, turistik. Veprimtari turistike, tregtare, industriale. Sherbime publike, bar-bufe, hoteleri, restorant, agjensi turistike, si dhe dhenie me qera apo parkim te anijeve turistike. Gjithashtu Shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjeter qe ka te bej me pronen e palujtshme te luajtshme , cdo veprim apo operacion tjeter komercial, industrial e financiar , te dobishem apo plotesues etj. | |
| 10. Administratori/ët | Giovanna Antonietta Sticca | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 24/05/2021 | Deri: 24/05/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Administratori/ët | Stella Giorgi | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 01/10/2021 | Deri: 01/10/2026 |
| 13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 14. Ortakët | Adriana Gjijnuri | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 666.666,00 | Natyre: |
| 14.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | ,33 | |

| | | |
|---|------------------|---------|
| - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues) | | |
| 15. Ortakët | VASILLAQKEDHI | |
| 15.1 Vlera e kapitalit | Para: 9.000,00 | Natyre: |
| 15.2 Numri i pjesëve | 9,00 | |
| 15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 4,50 | |
| - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues) | | |
| 16. Ortakët | LiriGjikhuri | |
| 16.1 Vlera e kapitalit | Para: 666.666,00 | Natyre: |
| 16.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 16.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | ,33 | |
| - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues) | | |
| 17. Ortakët | KAJTAZLIKAJ | |
| 17.1 Vlera e kapitalit | Para: 4.000,00 | Natyre: |
| 17.2 Numri i pjesëve | 4,00 | |
| 17.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 2,00 | |
| - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues) | | |
| 18. Ortakët | JosifKedhi | |
| 18.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.000,00 | Natyre: |
| 18.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 18.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | ,50 | |
| - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues) | | |
| 19. Ortakët | AndiGjikhuri | |
| 19.1 Vlera e kapitalit | Para: 666.666,00 | Natyre: |
| 19.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 19.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | ,33 | |
| - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues) | | |
| 20. Ortakët | AidaKedhi | |

| | | |
|--|---|---------|
| 20.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.000,00 | Natyre: |
| 20.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 20.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | ,50 | |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | | |
| 21. Ortakët | KETIKEDHI | |
| 21.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.000,00 | Natyre: |
| 21.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 21.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | ,50 | |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | | |
| 22. Ortakët | GE.POR.TUR | |
| 22.1 Vlera e kapitalit | Para: 182.000,00 | Natyre: |
| 22.2 Numri i pjesëve | 182,00 | |
| 22.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 91,00 | |
| 22.4 Komente (nëse ka) | | |
| 23. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 24. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: GE-POR-TUR E-Mail: geporturshpk@gmail.com Telefon: 0683161192 Të Tjera: Me vendimin e dt.05.112008 të shoqeris,specifikohet se të drejta të plota firme do të ketë administratorja Z.Sticca Giovanna | |
| 25. Statusi: | Aktiv | |

Data: 05/10/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)